| 1362 | 15.10.2021 | 462 | Paguar sipas fak,nr.462/X | 0.00 | 749.00 | 0.00 |
| 1362 | 25.05.2021 | 497 | Paguar sipas fak,nr.497/V ( maj) | 0.00 | 749.00 | 0.00 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1362 | 19.11.2021 | 467 | Paguar sipas fakt.nr467/XI | 0.00 | 749.00 | 0.00 |
| 1362 | 21.12.2021 | 468 | Paguar sipas fak.nr.468/XII | 0.00 | 749.00 | 0.00 |
| 1362 | 28.01.2022 | 473 | Pagur sipas fak.nr.473/I Paguar sipas fak.nr.473/I | 0.00 | 749.00 | 0.00 |
| 1362 | 22.02.2022 | 426 | Paguar sipas fakt.nr.426/II | 0.00 | 749.00 | 0.00 |
| 1362 | 22.03.2022 | 432 | Paguar sipas fak.nr.432/III | 0.00 | 749.00 | 0.00 |
| 1362 | 19.04.2022 | 440 | Paguar sipas fak.nr.439/IV | 0.00 | 749.00 | 0.00 |
| 1362 | 23.05.2022 | 441 | Paguar sipas fakt.441/V | 0.00 | 749.00 | 0.00 |
| 1362 | 05.01.2022 | 400-51418 | Ngarkimi I qeras 01.01.-31.12.2022 | 8,988.00 | 0.00 | 0.00 |
| 1362 | 27.06.2022 | 444 | Paguar sipas fakt.nr.444/VI-qershor 2023 | 0.00 | 749.00 | 0.00 |
| 1362 | 22.07.2022 | 446 | Paguar sipas fak.nr.446/VII-korrik 2022 | 0.00 | 749.00 | 0.00 |
| 1362 | 24.08.2022 | 449 | Paguar sipas fak.nr449/VIII-gusht 2022 | 0.00 | 749.00 | 0.00 |
| 1362 | 05.10.2022 | 450 | Paguar sipas fak.nr.450/X-shtator 2022 | 0.00 | 749.00 | 0.00 |
| 1362 | 08.11.2022 | 404 | Paguar sipas fak.nr.404/X-tetor 2022 | 0.00 | 749.00 | 0.00 |
| 1362 | 05.12.2022 | 405 | Paguar sipas fak.405/XI-nentor 2022 | 0.00 | 749.00 | 0.00 |
| 1362 | 06.01.2023 | 409 | Paguar sipas fak.nr.409/XII-per dhetor 2022 | 0.00 | 749.00 | 0.00 |
| 1362 | 01.01.2023 | 400-51418 | Ngarkimi I qeras 01.01.2023-01.01.2120 | 870,987.12 | 0.00 | 0.00 |
| 1362 | 26.01.2023 | 416 | Paguar sipas fat.nr.416/I | 0.00 | 749.00 | 0.00 |
| 1362 | 27.01.2023 | 419 | Paguar sipas fat.nr.419/II | 0.00 | 749.00 | 0.00 |
| 1362 | 22.03.2023 | 418 | Paguar sipas fat.nr.418/III | 0.00 | 749.00 | 0.00 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1362 | 08.06.2023 | 381 | Paguar sipas fat.nr.381/VI | 0.00 | 749.00 | 0.00 |
| 1362 | 08.06.2023 | 383 | Paguar sipas fat.nr.383/VI | 0.00 | 749.00 | 0.00 |
| 1362 | 08.06.2023 | 378 | Paguar sipas fat.nr.378/VI | 0.00 | 749.00 | 0.00 |
| 1362 | 14.08.2023 | 388 | Paguar sipas fat.nr.388/VIII | 0.00 | 749.00 | 0.00 |
| 1362 | 14.08.2023 | 387 | Paguar sipas fat.nr.387/VIII | 0.00 | 749.00 | 0.00 |
| 1362 | 10.10.2023 | 391 | Paguar sipas fat,nr.391/X(tetor) | 0.00 | 749.00 | 0.00 |
| 1362 | 10.10.2023 | 394 | Paguar sipas fat.nr.394/X(tetor) | 0.00 | 749.00 | 0.00 |
| 1362 | 12.12.2023 | 397 | Paguar sipas fat.nr397/XII(dhjetor) | 0.00 | 749.00 | 0.00 |
| 1362 | 12.12.2023 | 400 | Paguar sipas fat.nr.400XII(dhjetor) | 0.00 | 749.00 | 0.00 |
| 1362 | 08.11.2022 | 403 | Korigjimi pageses 403/XI | 0.00 | -749.00 | 0.00 |
| 1362 | 13.02.2024 | 353 | Paguar sipas fat.353/II(shkurt) | 0.00 | 749.00 | 0.00 |
| 1362 | 13.02.2024 | 359 | Paguar siaps fat.359/II (shkurt) | 0.00 | 749.00 | 0.00 |
| 1362 | 03.04.2024 | 360 | Paguar sipas fat.360/IV (prill) | 0.00 | 749.00 | 0.00 |
| 1362 | 03.04.2024 | 364 | Paguar sipas fat.364/IV (prill) | 0.00 | 749.00 | 0.00 |
| 1362 | 14.05.2024 | 367 | Paguar sipas fat.367/V (maj) | 0.00 | 749.00 | 0.00 |
| 1362 | 08.08.2024 | 370 | Paguar sipas fat.370/VIII 9Gusht) | 0.00 | 749.00 | 0.00 |
| 1362 | 08.08.2024 | 375 | Paguar sipas fat.375/VIII (Gusht) | 0.00 | 749.00 | 0.00 |
| 1362 | 08.08.2024 | 326 | Paguar sipas fat.326/VIII(Gusht) | 0.00 | 749.00 | 0.00 |
| 1362 | 08.08.2024 | 327 | Paguar sipas fat.327/VIII (gusht) | 0.00 | 749.00 | 0.00 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1362 | 01.10.2024 | 329 | Paguar sipas fat.329/X (tetor) | 0.00 | 749.00 | 0.00 |
| 1362 | 01.10.2024 | 333 | Paguar sipas fat.333/X9tetort) | 0.00 | 749.00 | 0.00 |
| 1362 | 26.03.2025 | 349 | Paguar sipas fat.349/II | 0.00 | 749.00 | 0.00 |
| 1362 | 26.03.2025 | 127 | Paguar sipas fat.127/III | 0.00 | 749.00 | 0.00 |
| 1362 | 26.03.2025 | 129 | Paguar sipas fat.129/III | 0.00 | 749.00 | 0.00 |
| 1362 | 21.05.2025 | 133 | Paguar sipas fatures 133/V | 0.00 | 749.00 | 0.00 |
| 1362 | 21.05.2025 | 136 | Paguar sipas fatures 136/V | 0.00 | 749.00 | 0.00 |
| 1362 | 19.06.2025 | 137 | Paguar sipas fatures 137/VI | 0.00 | 749.00 | 0.00 |
| 1362 | 14.08.2025 | 139 | Paguar sipas fatures 139/VIII | 0.00 | 749.00 | 0.00 |
| 1362 | 24.09.2025 | 144 | Paguar sipas fatures nr.144/IX | 0.00 | 749.00 | 0.00 |
| 1362 | 23.10.2025 | 147 | paguar sipas fatures 147/X | 0.00 | 749.00 | 0.00 |
| 1362 | 11.12.2025 | 279 | Paguar sipas fatures nr.279/XII | 0.00 | 749.00 | 0.00 |
| 1362 | 15.12.2025 | 281 | Paguar sipas fatures 281/XII | 0.00 | 749.00 | 0.00 |
| 1362 | 09.02.2026 | 0326000001 | Paguar sipas fatures 0326000001/I(Shkurt) | 0.00 | 749.00 | 0.00 |
| 1362 | 23.03.2026 | 0326000004 | Paguar sipas fatures 0326000004/I (e pag.per | 0.00 | 749.00 | 0.00 |
| 1362 | 23.03.2026 | 0326000007 | Paguar sipas fatures 0326000007/II(mars) | 0.00 | 749.00 | 0.00 |
| 1362 | 13.04.2026 | 0326000011 | Paguar sipas fatures 0326000011(Prill) | 0.00 | 749.00 | 0.00 |
| 1362 | 21.05.2026 | 0326000016 | Paguar sipas fatures 0326000016/Maj) | 0.00 | 749.00 | 0.00 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Totali i Debis | 889,812.00 | Totali i Kredis: | 47,268.88 | Totali i salldos | 842.543.12 |

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA GLLOGOC
GLLOGOC MUNICIPALITY
PRANUAR 15 / 06 / 2026

| Nj. Org. | Numër | Shtojca | Vlera |
| --- | --- | --- | --- |
| 07 | 052/03 | 22637 | |


**REPUBLIKA E KOSOVËS**
Republika Kosova-Republic of Kosovo
**Komuna Drenas/Gllogoc**
Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë

Bazuar në nenin 22, par.1 të Ligjit nr.06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme te komunës si dhe nenin 27, par 1 dhe 2 të rregullorës (QRK) nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës, Drejtoria për Gjeodezi, Kadaster dhe Pronë - Sektori i Pronës lidhur me mbikëqyrjen e kontratave për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të komunës paraqet këtë:

# RAPORT

**Zyrtarja për menaxhimin e pronave komunale të dhëna në shfrytezim, në zbatim të detyrave që rrjedhin nga Ligji per dhënien në shfrytëzim dhe këmbim te pronës së paluajtshme komunale dhe Rregullores (QRK) NR.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës, pas verifikimit të gjendjes në teren raporton te gjeturat e saj mbi gjendjen faktike lidhur me përmbushjen e kontratës Nr.01-400-51408, dt26.11.2020, Kryetarit te Komunes së Drenasit:**

Kontrata mbi dhënien në shfrytëzim afatëgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës Nr.01-400-51408, dt.26.11.2020, është e lidhur në mes te Komuna e Drenasit e përfaqësuar nga Kryetari i Komunës z.Ramiz Lladrovci në njëren anë dhe FER PETROL, me seli në Tërstenik, me nr të biznesit 810247967, të cilën e përfaqëson Mehdi Gjoka në anën tjetër, përmes së cilës e merr në shfrytëzim afatëgjatë për 99 (nëntëdhjetë e nentë) vite pronën komunale, parcelën nr.764-0, sipërfaqe 68.63m², në vendin e quajtur "Mahalla e Binakve" zona kadastrale Gllobar.
Obligimet ndërmjet palëve kontraktuese kanë filluar nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate dhe shfrytëzuesi i pronës komunale ka qenë i obliguar të i përmbahet obligimeve të përcaktuara me kontratë.

- Pas verifikimit në Kadastër dhe Gjeodezi konstatohet se e drejta e shfrytëzimit të pronës komunale në emër të shfrytëzuesit (Mehdi Gjoka-FER PETROL) është e regjistruar në Kadastër RDPP, në pjesën tekstuale dhe grafike.
- Me qëllim të verifikimit të kontratës dhe gjendjës së pronës, kemi dalur ne vendshiqim me dt.20.05.2026 dhe kemi konstatuar se shfrytëzuesi i pronës komunale në objektin që e ka ndërtuar në tokën e marrë në shfrytëzim për qëllime te zhvillimit të aktivitetetve afariste-ndërtimin e "Qendres Edukative ne Komunikacion". biznesi është aktiv, se përfituesi-shfrytëzuesi i pronës komunale, në objektin që e ka ndërtuar në pronën komunale të marrë në shfrytëzim, sipas deklarimeve të shfrytëzuesit të pronës komunale në pronën në fjalë zhvillohet veprimtaria e njejtë siç është e përcaktuar në kontratë përkatësisht në nenin 4 të saj.

- Bazuar në vendimin për Leje Ndërtimore 08.Nr.351-13560 të dt.20.05.2021 të lëshuar nga Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit-shfytëzuesit afatgjatë të pronës komunale i është lejuar ndërtimi i objektit afarist Depo me etazhitet P+0, me sipërfaqe bruto të ndërtimit S=268.22 m², në parcelën nr.P-70315015-00764-0 me sipërfaqe 6863m², prone e komunës e dhënë në shfrytëzim afatgjatë për 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vite kompanisë FER PETROL përmes procedures së shprehjes së interesit sipas Ligjit Nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës, në vendin e quajtur "Mahalla e Binakve", zona kadastrale Gllobar.
- Sipas Çertifikatës së Përdorimit 08.Nr.070-32430 të dt.04.07.2022 të lëshuar nga Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit është konstatuar se biznesi në fjalë në të dhënat e lartëpermendura dhe dokumentacionit të bashkëngjitur në lëndë si dhe raportin final të dorëzuar pranë kësaj Drejtorie, punimet janë zhvilluar në harmoni me dokumentacionin e ndërtimor/projektin kryesor, si dhe normat dhe standardet në fuqi.
- Gjatë vizitës në terren, është prezantuar edhe Çertifikata e Biznesit-ARBK, ky biznes vepron me emërtimin FER PETROL-Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me numër 810834673.
- Pas verifikimit të kontratës dhe gjëndjes së pronës, vlera e investimeve, sipas shfrytëzuesit të pronës komunale ka arritur vlerën 1,750,100.00 (një milion e shtatëqind e pesëdhjetë mijë e njëqind euro). ka ndërtuar objektin e përshtatshëm për ushtrimin e veprimtarisë së përcaktuar në kontratë gjendja e objekti pasqyrohet përmes fotografive të bëra në vendshiqim.
- Bazuar në evidencën e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, gjendjën e kartelës nr.1329, të marrë nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa, në emër të shfrytëzuesit të pronës komunale (Mehdi Gjoka) është paguar qiraja, ashtu siç është përcaktuar me nenin 5 të kontratës, shfrytëzuesi i pronës komunale është i rregulltë në pagesat e qirasë.
- Sa i përket numërit të punëtorëve, shfrytëzuesi i pronës komunale ka deklaruar listën me 40 (dyzetë) punëtor të punësuar në këtë biznes.

Pas verifikimit të kontratës Nr.01-400-51408, dt.26.11.2020, gjendjës së pronës në parcelën nr.764-0, zona kadastrale-Gllobar dhe në bazë të evidencës së Drejtorisë për Buxhet dhe Financa vlerësojm se shfrytëzuesi i pronës komunale është brenda kritereve kontraktuale sa i përket aktiviteteve afariste të bizneseve siç e përcakton neni 4 i kësaj kontrate.
Ndërsa lidhur me objektin si në emërtim "Qendra Edukative në Komunikacion" gjatë verifikimit në vendshiqim nuk kemi vërejtur ndonjë veprimtari ose objekt që ndërlidhet me titullin e lartëpërmendur mirëpo sipas deklarimeve te shfrytëzuesit afatgjatë të pronës komunale (Mehdi Gjoka) titulli i lartë cekur i përfshin veprimtarit të përcaktuara në kontratë siç janë: Pikë Shitëse e Derivatev, Restaurant, Kënd i Lodrave dhe Auto-Larje.
Lidhur me këtë çështje bazuar në raportin paraprak, Zyra e Kryetarit me datë 12.05.2026 këtij biznesi i ka dërguar vërejtje me shkrim për verifikimin e emërtimit të kontratës. Ndërsa subjekti në fjalë ka parashtruar kërkesë me shkrim pranë Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe pranë Zyrës së Kryetarit me dt.09.06.2026 ku kanë kërkuar shqyrtimin e vërejtjes dhe korigjimin/verifikimin e emërtimit në kontratë, duke e harmonizuar sipas dokumentacionit ekzistues. Ndryshimin e emërtimit nga Qendër Edukative për Komunikacion dhe aktivitete afariste në Pompë e Derivateve me aktivitete afariste duke përfshirë Pompën e Derivateve, restaurant, market, auto larje dhe kënd i lojërave.

Pas verifikimit të kontratës Nr.01-400-51408, dt.26.11.2020, gjendjes së pronës në parcelën numër 764-0, zona kadastrale Gllobar, evidencës së Drejtorisë për Buxhet dhe Financa si dhe në bazë të dokumentacionit të shqyrtuar dhe verifikimeve të kryera në terren, konstatohet gjendja faktike e pronës sipas të dhënave të paraqitura në dokumentacionin përkatës. Të gjitha të gjeturat janë evidentuar në këtë raport në përputhje me dokumentacionin e bashkëngjitur dhe gjendjën e konstatuar në terren.

Zyrtare për Menaxhimin e Pronës Komunale

Dafina Leku

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA GLLOGOC - OPŠTINA GLOGOVAC - MUNICIPALITY GLLOGOC







REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA GLLOGOC
GLLOGOC MUNICIPALITY

| Pranuar 26/11 | | | 202 |
|---|---|---|---|
| Nj. Org. | Numër | Shtojca | Vlera |
| 01- | 400- | 51408 | |

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna Gllogoc
Opština Glogovac
Municipal Assembly

Duke u bazuar në nenin 19 paragrafi 3, nënparagrafi 3.2 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, lidhur me nenin 22 paragrafi 2 dhe 3 të Pregullores Nr.(QRK) Nr 09/2020, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, në shfrytëzim afatëgjatë prej nëntëdhjetë e nëntë (99) vite të pronës së paluajtshme të Komunës së Gllogocit, duke vepruar sipas Rekomandimit të Komisionit Vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës 01-Nr.052/03-43188 të datës 09.10.2020 për zgjedhjen e ofertës ekonomikisht më të favorshme, Vendimin e Kuvendit të Komunës 12-Nr 462/01-47354 dt. 30.10.2020, Konfirmimin e ligjshmërisë së aktit të Komunës së Gllogocit nga Ministria e Pushtetit Lokal Nr.020-828/10 datë 19.11.2020, Kryetari i Komunës lidh kontratë me të cilën përcaktohen të drejtat dhe obligimet e palëve kontraktuese:

## KONTRATË PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

### Neni 1.

**Palët**

**1) Komuna e Gllogocit, e përfaqësuar nga Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci, në tekstin në vijim "Autoriteti Kontraktues", dhe**

2) FER Petrol e regjistruar në zyren e bizneseve në Gllogoc, me zbatimin e ligjit për numrin unik identifikues të biznesit ka këtë NUI: 810247967, Komuna e Gllogocit, e përfaqësuar nga Mehdi Gjoka Drejtor, në tekstin në vijim "Operatori Ekonomik"

### Neni 2.

Lënda e Kontratës:

Duke ju nënshtruar kushteve të parashtruara në këtë kontratë, Autoriteti Kontraktues jep në shfrytëzim afatgjatë për 99 ( nëntëdhjetë e nëntë) vite Operatorit Ekonomik, dhe Operatori

[illegible] ne shfrytëzim [illegible] në ngastrën [illegible] parcelën kadastrale Nr.P-70315019-[illegible]-0, pronë shoqërore e Kuvendit të Komunës së Gllogocit.

Neni 3.

Autoriteti Kontraktues është pronar i pronës së paluajtshme komunale të përcaktuar në nenin 1 të kësaj kontrate, në tekstin në vijim e referuar si "objekti i kontratës"

Neni 4

5.1 Objekti i kontratës është i paradestinuar nga Autoriteti Kontraktues për aktivitete afariste të bizneseve, për përmbushjen e interesit publik dhe zhvillimin ekonomik lokal. Operatori Ekonomik do të shfrytëzoj objektin e kontratës për qëllime të zhvillimit të aktiviteteve afariste – ndërtimin e Qendra Edukative në Komunikacion, sipas projekt propozimit të paraqitur tek Autoriteti Kontraktues dhe kushteve të zhvillimit të projektit.

5.2 Operatori Ekonomik obligohet që ti përmbahet planit dinamik realizues ( plani dinamik me 01-Nr 070-50486 të datës 19.11.2020, Vendimi i Kuvendit të Komunës 12-Nr.462/01-47354 datë 30.10.2020, Konfirmimi i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Gllogocit nga Ministria e Pushtetit Lokal Nr.020-828/10 datë 19.11.2020, Njoftimi publik 01-Nr.462/01-38720 datë 16.09.2020 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë prej nëntëdhjetë e nëntë (99) vite të pronës së paluajshme komunale, Raporti i vlerësimit të ofertave 01-Nr.052/03-43188 datë 09.10.2020, Njoftimi publik 01-Nr.462/01-43186 datë 09.10.2020, janë pjesë e kësaj kontrate).

5.3 Operatori Ekonomik obligohet të filloje punën në afat prej 4 muajsh, nga dita e nënshkrimit të kësaj kontrate.

Neni 5.

Operatori Ekonomik obligohet të bëjë pagesën e shfrytëzimit afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës siç është paraqitur në projektin ofertues me n[illegible]

Neni 6.

6.1 Autoriteti Kontraktues pajohet të ofroj çasje të lirë Operatorit Ekonomik në objektin e kësaj kontrate, per tërë periudhën e shfrytëzimit të tij.

## Neni 7.

Objekti i kontratës

7.1. Autoriteti Kontraktues ia jep në shfrytëzim pronën Operatorit Ekonomik, ndërsa Operatori Ekonomik [illegible] në shfrytëzim nga Autoriteti Kontraktues [illegible]

7.2. [illegible]

7.3. [illegible]

7.4. Madhësia e pronës

7.5. Të dhëna tjera në lidhje me pronën

## Neni 8.

**Kohëzgjatja, vazhdimet dhe anulimi i hershëm:**

8.1. Duke iu nënshtruar edhe afateve të tjera të kësaj Kontrate, kohëzgjatja e kësaj Kontratë për dhënjen në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës është për 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vite, që fillon të llogaritet nga data e nënshkrimit të kësaj Kontrate.

8.2. Në rast të mos realizimit të planit dinamik të kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës duke tejkaluar afatet e përcaktuara me kontratë, Kryetari i Komunës e ka të drejtën e marrjes vendimit për shkëputjen e kontratës. Më këtë vendim njoftohet Kuvendi i Komunës.

8.3. Në rast të evidentimit të shkeljes së Kontratës apo shmangies nga qëllimi i shfrytëzimit të pronës së paluajtshme të komunës nga shfrytëzuesi, Kryetari i Komunës obligohet që në afat kohë të njoftoj Kuvendin e Komunës me shkrim së bashku me rekomandimin e tij për shkëputjen e kontratës apo masat e ndërmarra ndaj shfrytëzuesit.

8.4. Nëse Operatori Ekonomik nuk i plotëson [illegible] në rast i paraparë, Autoriteti Kontraktues mund të zgjidh këtë kontratë [illegible] sipas dispozitave ligjore në fuqi.

[illegible] për ta zbatuar këtë Kontratë. [illegible]

Neni 9.

9.1 Pas përfundimit të afatit të përcaktuar në kontratën për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, prona i kthehet komunës.

9.2 Kryetari i Komunës obligohet që ta njoftoj Kuvendin e Komunës pas përfundimit të çdo kontrate të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, duke përshkruar gjendjen aktuale të pronës, si dhe të jap propozimet për destinimin e saj në të ardhmen.

9.3 Pas përfundimit të kontratës për shfrytëzimin afatgjatë të pronave të paluajtshme të komunës, mund t'i vazhdohet afati në bazë të performancës.

Neni 10.

**Mbikëqyrja e kontratave:**

10.1. Komuna mbikëqyrë realizimin e kontratave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës sipas planit dinamik të realizimit.

10.2. Kryetari i Komunës obligohet që në raport vjetor [illegible] të paraqes Kuvendit të Komunës edhe raportimin e tij, [illegible] për monitorimin e realizimit të kontratave, edhe përmbushjes së qëllimit të dhënies në shfrytëzim të pronave të paluajtshme, deri në nivelin e implementimit dhe arritjes së qëllimit të dhënies së pronës në shfrytëzim.

Neni 11

[illegible] datë 30.09.2021 [illegible] Kryetari [illegible] ka të drejtë të shkëpus kontratën [illegible]

Neni 12

Operatori Ekonomik obligohet që pas nënshkrimit të kësaj kontrate të përmbahet afatit të paraparë në planin dinamik, të përgatisë të gjithë infrastrukturën e nevojshme ligjore për fillimin e punimeve, duke siguruar shëndetësimin apo dëshmimin e saj në të mirë dhe interes të përgjithshëm .

Neni 13.

Kontestet eventuale lidhur me këtë kontratë, kontraktuesit do ti zgjidhin me mirëkuptim dhe marrëveshje, dhe në rast se këtë nuk mund të arrijnë atëherë kontestet do të zgjidhen në Gjykatën Kompetente.

Neni 14.

Kjo kontratë është përpiluar në ekzemplar të mjaftuar për palën kontraktuese, palët kontraktuese e kanë lexuar dhe kanë kuptuar përmbajtjen e kësaj kontrate, dhe në shenjë të pajtimit të vullnetit të tyre e nënshkruajnë pa vërejtje.

Neni 15.

Kjo kontratë hyn në fuqi me nënshkrimin nga [illegible] e palëve kontraktuese.

Kryetari i Komunës së [illegible]

z. Rami [illegible]

FER Petrol

z. Mehdi Gjeka

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
**KOMUNA E DRENASIT**
**KUVENDI I KOMUNËS**

12 Nr. 462/01-47354 dt. 30.10 2020

Bazuar në nenin 11,12,dhe 40,të Ligjit Nr.03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale, nenin 5, nenin 6 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2, nenin 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2, nenin 19 paragrafi 3 nënparagrafi 3.1 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenin 13, 14, 22 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës të Komunës, duke vepruar sipas Rekomandimit të Komisionit Vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës 01-Nr.052/03-43188 të datës 09.10.2020 për zgjedhjen e ofertës ekonomikisht më të favorshme. Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë **30.10.2020,** miraton këtë:

**V E N D I M**
**Për Dhënien në Shfrytëzim Afatgjatë prej nëntëdhjetë e nëntë (99) vite të Pronës së Paluajtshme të Komunës për Kompanin Fer Petrol Gllobar**

**Neni 1**

Miratohet Vendimi për Dhënien në Shfrytëzim Afatgjatë prej nëntëdhjetë e nëntë (99) vite të Pronës së Paluajtshme të Komunës, përmes procedurës së shprehjes së interesit, Kompanisë Fer Petrol në parcelën kadastrale nr.P-70315015-00764-0, në sipërfaqe të përgjithshme 6863.0 m², që gjendet në vendin e quajtur ''Mahalla Binakve'', zona kadastrale Gllobar, në pronësi të Komunës së Gllogocit.

**Neni 2**

Afati kohor për dhënien në shfytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës të përshkruar në pikën 1 të këtij vendimi është afatgjatë në periudhën prej nëntëdhjetë e nëntë (99) vite.

**Neni 3**

Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës është interesi publik dhe përftimi financiar dhe ekonomik i Komunës së Gllogocit nga prona komunale.

**Neni 4**

Pas miratimit të vendimit përfundimtar nga ana e Kuvendit të Komunës, autorizohet Kryetari i Komunës që brenda dhjetë (10) ditë pune nga hyrja në fuqi e vendimit të lidhë kontratë me fituesin.

**Neni 5**

Kontrata për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës nënshkruhet nga kryetari i komunës i cili përfaqëson komunën dhe nga fituesi i përzgjedhur, me anë të së cilës përcaktohen të drejtat dhe obligimet e palëve kontraktuese.

**Neni 6**

Prona e paluajtshme që jepet në shfrytëzim, e përshkruar në pikën I të këtij vendimi, duhet të evidentohet në librat kadastralë të Komunës.

**Neni 7**

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

**Neni 8**

Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë: Certifikata e pronësisë dhe kopja e planit.

**Neni 9**

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MPL si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Drejtorisë Përkatëse;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit .

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**

**Labinot Halilaj**

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova-Republic of Kosovo
**Komuna e Gllogocit**
Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit

**08-Nr** 351-13560 **dt.** 20.05.**2021**

Në bazë të neneve 14, 15, 19, 20 dhe 21 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim, nenit 44 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe aplikacionit të Fer Petrol me përfaqësues Mehdi Gjoka nga fshati Gllobar, Komuna e Gllogocit, të paraqitur me numër të protokollimit 08-Nr.351-13560 të datës 24.04.2021, Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit me datë 20.05.2021, lëshon këtë:

**VENDIM**

**(për Leje Ndërtimore)**

| **Kjo Leje Ndërtimore i lëshohet:** | | | |
|---|---|---|---|
| Emri: | Mehdi Gjoka, Fer Petrol | | |
| Adresa: | Rr. ''Sheremet Binaku'', Gllobar | | |
| Telefoni: | | Emaili: | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Emri i Projektit: | Ndërtimi i Objektit afarist Depo P+0 | | |
| Emri i Projektuesit: | N.P.N ''Inzhinjering'' | | |
| Adresa: | | | |
| Telefoni: | +38344841758 | Emaili: | hamdi_qorri@hotmail.com |

| **Për punët ndërtimore në vijim:** | | |
|---|---|---|
| | | |
| Zona (t) Kadastrale: Gllobar | Nr. i parcelës kadastrale: P-70315015-00764-0 | GPS Koordinatat: X=4721840.678 |

F. A

| | | |
|---|---|---|
| | | Y=7489931.482 |

| |
|---|
| **Lloji i ndërtimit të propozuar:** |
| Ndërtim i ri ☒ Rindërtim ☐ Rrënim ☐ Riparim ☐ Tjetër ☐ |
| **Kategoria e ndërtimeve të propozuara:** |
| Kategoria I ☒ Kategoria II ☐ Kategoria III ☐ |

| | |
|---|---|
| **Përdorimi i propozuar:** | A përfshin kërkesa ndryshim të destinimit? Po ☒ Jo ☐ |
| Shtëpi ☐ Banesë kolektive ☐ Përdorim i përzier ☐ Afarist ☒ Industrial ☐ Infrastrukturë ☐ Tjetër: ☐ | |
| Përshkrimi: Ndërtimi i objektit afarist Depo me etazhitet P+0 me sipërfaqe bruto të ndërtimit S=268.22 m², në parcelën kadastrale P-70315015-00764-0 me sipërfaqe 6863 m², pronë e komunës e dhënë në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite kompanisë Fer Petrol, që gjendet në vendin e quajtur ''Mahalla Binakve'', zona kadastrale Gllobar. | |

Me këtë vendim, poseduesit të lejes ndërtimore kompanisë Fer Petrol me përfaqësues Mehdi Gjoka, i lejohet ndërtimi i Objektit afarist Depo me etazhitet P+0.

**Poseduesi i Lejes Ndërtimore është i obliguar që:**

- Të fillojë me punët ndërtimore brenda një (1) viti nga data e dhënies së kësaj leje ndërtimore, përveç nëse zgjatet afati i vlefshmërisë se saj në pajtim me Ligjin;
- Të sigurojë që kontraktuesi në vendndërtim posedon dokumentet e mëposhtme:
  - një kopje të kësaj leje ndërtimore;
  - një kopje të kontratës ndërmjet poseduesit të lejes ndërtimore dhe kontraktuesit nëse punët ndërtimore kryhen nga një palë e tretë;
  - një kopje e të gjitha dokumenteve të ndërtimit që janë nënshkruar ose vulosur si të "APROVUAR" nga organi kompetent;
  - 
  - projektin kryesor me te gjitha fazat për nevoja të realizimit të ndërtimit;

P. A.

- dokumentacionin që tregon konformitetin e produkteve të ndërtimit dhe pajisjeve me kërkesat rregullative, dhe me dokumentet e aprovuara të ndërtimit;

- librin dhe ditarin ndërtimor, që duhet të përmbajnë regjistër të hollësishëm ditor të të gjitha punëve ndërtimore, përfshirë të dhëna të shkruara dhe skematike, që dokumentojnë: datën, vendin dhe rezultatet e testeve të kryera në materialet ose punët ndërtimore; Përshkrim të problemeve të hasura gjatë ndërtimit dhe inspektimit dhe mënyrën se si janë zgjidhur si dhe;

- kartelën e inspektimeve të miratuara, të vendosur në vend të dukshëm dhe e ruajtur nga dëmtimi nga moti sepse është i domosdoshëm kur investuesi të aplikoj për certifikatë të përdorimit;

- Të dorëzoj njoftim inspektoratit të Organit Kompetent mbi synimin për fillimin e ndërtimit së paku shtatë (7) ditë para fillimit të punëve ndërtimore;

- Të kontaktojë organin kompetent për të kryer inspektimet siç kërkohet me ligj, dhe akte nënligjore. Këto inspektime nuk e lirojnë aplikuesin për leje ndërtimore dhe/ose arkitektin apo inxhinierin e licencuar përgjegjës për sigurimin e inspektimeve adekuate dhe mbikëqyrje ditore të punëve ndërtimore;

**A r s y e t i m**

Aplikuesi Fer Petrol me përfaqësues Mehdi Gjoka nga Komuna e Gllogocit ka kërkuar me kërkesën me numër të protokollimit 08.Nr.351-13560 të datës 24.04.2021, nga Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit lëshimin e Lejes Ndërtimore për ndërtimin e objektit afarist Depo me etazhitet P+0 në sipërfaqe bruto të ndërtimit S=268.22 m² në parcelën kadastrale P-70315015-00764-0, pronë e komunës e dhënë në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite kompanisë Fer Petrol, në sipërfaqe 6863 m² që gjendet në vendin e quajtur ''Mahalla Binakve'', zona kadastrale Gllobar. Kjo Leje Ndërtimore bazohet në shqyrtimin e provave: kopja e planit, certifikata e pronësisë e evidentuar si pronë e komunës e dhënë në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite kompanisë Fer Petrol, Vendimin për caktimin e kushteve të ndërtimit 08-Nr.351-13560 dt. 21.04.2021, pëlqimin për rregullim të dokumentacionit teknik Nr.3943 dt. 30.04.2021 nga KEDS, projektin kryesor në kopje fizike dhe kopje elektronike punuar nga kompania projektuese N.P.N ''Inzhinjering'' me numër të biznesit 80168390, vërtetimin e tatimit në pronë Nr.2037589 të datës 22.04.2021, faturën e pagesës 0321000148. Pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit të ndërtimor të lëndës, si dhe bazuar në Ligjin Nr.04/L-110 për Ndërtim, Ligjin Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe dispozitat tjera të ligjit në fuqi, u konstatua se janë

F. A

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA GLLOGOC
GLLOGOC MUNICIPALITY
PRANUAR 12/05/2026
Nj. Org. | Numër | Shtojca | Vlera
01- 400/01- 16902

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
**Qeveria-Vlada-Government**
**Komuna e Drenasit/Gllogocit**
**Zyra e Kryetarit**

GLLOGOC

| | |
|---|---|
| Datë: | 12.5.2026 |
| Për/za/to: | FER PETROL të cilën e përfaqëson z. Mehdi Gjoka, me seli në Terstenik |
| Nga /od/from: | Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës së Drenasit |
| Cc. | Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë |
| Tema/subjekat/subject: | Vërejtje për përmbushjen e obligimeve kontraktuale të kontratës Nr.01-400-51408 dt:26.11.2020 |

Të nderuar,

Ashtu siç jeni në dijeni edhe ju Komuna e Drenasit përfaqësuar nga Kryetari i Komunës së Drenasit z.Ramiz Lladrovci ka lidhur kontratë mbi dhënien në shfrytëzim afatgjatë pronën e paluajtshme të Komunës Nr.01-400-51408 dt:26.11.2020 e lidhur në mes Komunës së Drenasit dhe FER PETROL të cilën e përfaqëson z. Mehdi Gjoka, me seli në Terstenik, pjesën e ngastrës/parcelës nr.764-0, sipërfaqe 68.63 metër katror, në vendin e quajtur Mahalla e Binakve , zona kadastrale Gllobar në të cilën do të ndërtohet objekt për ushtrimin e veprimtarisë – ndërtimin e Qendra Edukative në Komunikacion sipas projekt propozimit të paraqitur tek Autoriteti Kontraktues dhe Kushteve të Zhvillimit të Projektit, për një periudhë prej nëntëdhjetë e nëntë (99) vite.

Sipas raportit të Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë - Sektori i Pronës në kuadër të mbikëqyrjes së kontratave për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të komunës i datës 31.12.2025 me nr.07-052/01-55264 është konstatuar se sipas gjendjes faktike në teren dhe konstatimeve të bëra nga ana juaj, në përgjithësi janë të plotësuara obligimet kontraktuale të kontratës së lartcekur, përjashtimisht asaj që sa i përket aktiviteteve afariste të bizneseve siç përcakton neni 4 i kësaj kontrate lidhur me objektin si në emërtim "Qendra Edukative në Komunikacion" gjatë verifikimit në vendshiqim nga kjo drejtori nuk kanë vërejtur ndonjë veprimtari ose objekt që ndërlidhet me titullin e lartpërmendur duke rekomanduar që të verifikohet emërtimi juridik i kontratës së lartpërmendur pasi që sipas deklarimeve të juaja titulli i lartcekur i përfshin veprimtarit e përcaktuara në kontratë siç janë pikë shitëse e derivateve, restorant, kënd i

lodrave dhe autolarja, **për çka edhe udhëzoheni të paraqiteni në Drejtorin për Gjeodezi Kadaster dhe Pronë për eleminimin e këtyre të metave të lartcekura** në mënyrë që ashtu sic parashihet në kontratën e lartcekur detyrimet e së cilës me vullnet të plotë i keni pranuar si të tilla të përmbushen në përpikmëri përmes përmbushjes të së cilave do të arrihet edhe eliminimi i veprimeve të tjera procedurale për të cilat ne si institucion në një situatë të tillë do të detyrohemi të i ndërmarrim.

Me respekt!

FER PETROL

*N.T Fer-Petrol*
*NrUNI: 810247967*

*Tel: 045-226-563*
*Add: Tërstenik-Drenas*

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA GLLOGOC
GLLOGOC MUNICIPALITY

| PRANUAR | 09 / 06 / 2026 | | |
|---|---|---|---|
| Nj. Org. | Numër | Shtojca | Vlera |
| 01 | 070/01 | 21633 | |

# KËRKESË

**Drejtuar:** Komunës së Drenasit – Zyra e Kryetarit

**Lënda:** Kërkesë për Ndryshimin e Emërtimit të Kontratës

I nderuar Kryetar Z.Ramiz Lladrovci

Në bazë të vërejtjes së pranuar nga ana e juaj, lidhur me verifikimin e emërtimit të kontratës me nr. 01-400-51408, dt. 26.11.2020, ju njoftojmë se në parcelën nr. 764-0, sipërfaqe 68.63 m², në vendin e quajtur "Mahalla e Binakve", zona kadastrale Gllobar, sipas objektit të kontratës "Qendër Edukative në Komunikacion" dhe aktivitetit afarist jemi duke e zhvilluar aktivitetin e njëjtë ashtu siç e parasheh neni 4 i kontratës. Veprimtaria e cila është lejuar nga Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit, ku bashkëngjitur gjeni lejen e lëshuar nga kjo Drejtori.

Sa i përket pjesës së emërtimit "Qendër për Komunikacion", ashtu siç e keni cekur edhe në vërejtje, mungon kjo pjesë e cila nuk ka qenë e paraparë në projektin tonë, mirëpo gjatë rregullimit të dokumentacionit nuk kemi gjetur emërtim adekuat, me ç'rast e kemi përdorur këtë emërtim. Kjo dëshmohet në bazë të dokumentacionit. Për këtë arsye, kërkojmë që të bëhet korrigjimi/verifikimi i emërtimit në kontratë, duke e harmonizuar sipas dokumentacionit ekzistues.

Të dhënat dhe dokumentet e tjera mbeten të pandryshuara, kërkesa jonë ka të bëjë vetëm me ndryshimin e emërtimit të kontratës. Theksojmë se ky ndryshim ka të bëjë vetëm me emërtimin dhe **nuk ndikon në objektin e kontratës, planin investiv, destinimin e pronës, kushtet kontraktuale apo zhvillimin e aktiviteteve afariste të parapara dhe të miratuara**. Të gjitha obligimet e përcaktuara me kontratë mbeten të pandryshuara dhe do të zbatohen sipas kushteve të aprovuara.

Prandaj, ju lutemi të aprovoni ndryshimin e emërtimit nga:

**Emërtimi aktual:** Qendra Edukative në Komunikacion

**Emërtimi i ri:** Pompa e Derivateve me aktivitete afariste, qe perfshine pomp e derivateve, restaurant, market, auto larje dhe kendi i lojrave.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin, presim shqyrtimin pozitiv të kësaj kërkese.

N.T Fer Petrol
Dt: 09.06.2026

FER PETROL

Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave - Ministarstvo za Finansije - Ministry of Finance
Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosovo -Tax Administration of Kosovo

# Lista e Pagave

**Periudha** 04 2026

| | | | |
|---|---|---|---|
| Numri Fiskal | 810247967 | Kontakti | MEHDI-GJOKA |
| Tatimpaguesi | Mehdi Gjoka | Adresa | TËRSTENIK |
| Regjioni | DTM | Tel | 44207411 44207411 44207411 |
| Lloji Kompanisë | Individual | Aktiviteti | Tregtia me pakicë e karburantit për automjete në dyqane të specializuar |

| | Nr. Personal | Emri | Paga Bruto | Kon. e Punëtorit | Kon. e Punëdhënësit | Tatimi | Primare | Ka Kontribute | Ka Tatim |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 1243795792 | ADRIAN GJOKA | 434.78 | 21.74 | 21.74 | 13.04 | PO | PO | PO |
| 2 | 1243821289 | ADRIATIK GJOKA | 550.87 | 27.54 | 27.54 | 23.33 | PO | PO | PO |
| 3 | 1251501633 | ALBAN BINAKU | 434.78 | 21.74 | 21.74 | 13.04 | PO | PO | PO |
| 4 | 1253131361 | ALBAN IMERI | 492.39 | 24.62 | 24.62 | 17.78 | PO | PO | PO |
| 5 | 1173939376 | ALDERIM RAMAJ | 1,720.47 | 86.02 | 86.02 | 134.45 | PO | PO | PO |
| 6 | 1176506446 | ARBENITA GJOKA | 350.11 | 17.51 | 17.51 | 6.61 | PO | PO | PO |
| 7 | 1240313886 | ARIAN GJOKA | 550.87 | 27.54 | 27.54 | 23.33 | PO | PO | PO |
| 8 | 1014732418 | ARLINDA GLLAREVA GJOKA | 350.11 | 17.51 | 17.51 | 6.61 | PO | PO | PO |
| 9 | 1500276599 | AVNI GJOKA | 354.69 | 17.73 | 17.73 | 6.96 | PO | PO | PO |
| 10 | 2015709637 | AVNI MORINA | 550.88 | 27.54 | 27.54 | 23.33 | PO | PO | PO |
| 11 | 1014742146 | BLERIM MAKOLLI | 350.11 | 17.51 | 17.51 | 6.61 | PO | PO | PO |
| 12 | 1015509755 | BUJAR HALILAJ | 434.78 | 21.74 | 21.74 | 13.04 | PO | PO | PO |
| 13 | 1243749502 | DRILON BALECI | 550.87 | 27.54 | 27.54 | 23.33 | PO | PO | PO |
| 14 | 1171895312 | FAHREDIN MORINA | 434.78 | 21.74 | 21.74 | 13.04 | PO | PO | PO |
| 15 | 2021556567 | FATMIRE GJOKA | 350.11 | 17.51 | 17.51 | 6.61 | PO | PO | PO |
| 16 | 1174348916 | FIDAN PROKSHI | 434.78 | 21.74 | 21.74 | 13.04 | PO | PO | PO |
| 17 | 1015546278 | FIKRET GJOKA | 434.78 | 21.74 | 21.74 | 13.04 | PO | PO | PO |
| 18 | 1241685736 | FLORIAN ZHUSHI | 550.87 | 27.54 | 27.54 | 23.33 | PO | PO | PO |
| 19 | 1015548947 | GAZMEND DVORANI | 480.70 | 24.04 | 24.04 | 16.67 | PO | PO | PO |
| 20 | 1171899377 | ILIR LEKU | 434.78 | 21.74 | 21.74 | 13.04 | PO | PO | PO |
| 21 | 1005714555 | ISA BINAKU | 434.78 | 21.74 | 21.74 | 13.04 | PO | PO | PO |
| 22 | 1174641958 | JASHAR GJOKA | 354.69 | 17.73 | 17.73 | 6.95 | PO | PO | PO |
| 23 | 1015260072 | KUSHTRIM HALILAJ | 550.88 | 27.54 | 27.54 | 23.33 | PO | PO | PO |
| 24 | 1242186687 | LEON ELSHANI | 1,135.67 | 56.78 | 56.78 | 78.89 | PO | PO | PO |
| 25 | 1241659204 | LIRIGZON ZHUSHI | 550.87 | 27.54 | 27.54 | 23.33 | PO | PO | PO |
| 26 | 1241632322 | MERITON BALIU | 609.36 | 30.47 | 30.47 | 28.89 | PO | PO | PO |
| 27 | 1010433289 | MIGJEN GJOKA | 550.88 | 27.54 | 27.54 | 23.33 | PO | PO | PO |
| 28 | 2171397807 | NAFIJE GJOKA | 350.11 | 17.51 | 17.51 | 6.61 | PO | PO | PO |
| 29 | 1235328859 | PËLLUMB KURTAJ | 550.88 | 27.54 | 27.54 | 23.33 | PO | PO | PO |
| 30 | 1174940521 | PETRIT GJOKA | 667.84 | 33.39 | 33.39 | 34.45 | PO | PO | PO |
| 31 | 1010462041 | RAGIP HETA | 667.84 | 33.39 | 33.39 | 34.45 | PO | PO | PO |
| 32 | 1015546588 | RASHIT GJOKA | 550.87 | 27.54 | 27.54 | 23.33 | PO | PO | PO |
| 33 | 1015548700 | SADAT GJOKA | 755.56 | 37.78 | 37.78 | 42.78 | PO | PO | PO |
| 34 | 1171629183 | SARANDA GJOKA | 350.11 | 17.51 | 17.51 | 6.61 | PO | PO | PO |
| 35 | 1230917066 | SARANDA SHALA KURTAJ | 550.88 | 27.54 | 27.54 | 23.33 | PO | PO | PO |
| 36 | 1171621409 | SHEREMET GJOKA | 550.88 | 27.54 | 27.54 | 23.33 | PO | PO | PO |
| 37 | 1232349740 | SHKELZEN MULAJ | 550.87 | 27.54 | 27.54 | 23.33 | PO | PO | PO |
| 38 | 1242578143 | VALENDONA BYLYKBASHI | 434.78 | 21.74 | 21.74 | 13.04 | PO | PO | PO |
| 39 | 1233319755 | VEPRIM BYLYKBASHI | 667.83 | 33.39 | 33.39 | 34.44 | PO | PO | PO |
| 40 | 1170431495 | VISAR THAQI | 1,135.67 | 56.78 | 56.78 | 78.89 | PO | PO | PO |

# Gjendja në Kartelë

| | |
|---|---|
| Nr i kartel. | 1329 |
| Firma | NT.EI,,FER PETROL" |
| Emri | MEHDI |
| Mbiemri | XHOKA |
| Veprimtaria | OERAMARRËS |
| Adresa | TERSTENIK-GLLOBA |

| ID | Data e rexhistr | Nr i urdhërit | Pershkrimi | Debi | Kredi | Salldo |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1329 | 20.10.2015 | 24 | Paguar sipas fakt,nr.24/X | 0.00 | 1,000.00 | 0.00 |
| 1329 | 14.06.2016 | *elektronik | Paguar sipas rap.bankar ne qershor | 0.00 | 1,000.00 | 0.00 |
| 1329 | 21.06.2011 | 462-4634 | Ngark.e qera.06.07.2010-06.07.2020 | 10,000.00 | 0.00 | 0.00 |
| 1329 | 01.07. 2011 | 80 | Paguar sipas rap.80/VII | 0.00 | 1,000.00 | 0.00 |
| 1329 | 24.09.2012 | 115 | Paguar sipas raport.115/IX | 0.00 | 1,000.00 | 0.00 |
| 1329 | 05.09.2013 | 143 | paguar sipas rap.143/IX | 0.00 | 1,000.00 | 0.00 |
| 1329 | 03.12.2014 | 176 | Paguar sipas fakt.nr.176/XII | 0.00 | 1,000.00 | 0.00 |
| 1329 | 23.06.2017 | 35 | Paguar sipas fakt.nr.35/VI | 0.00 | 1,000.00 | 0.00 |
| 1329 | 01.10.2018 | elektr. | Paguar sipas fakturimit .dt.11.09.18 | 0.00 | 1,000.00 | 0.00 |
| 1329 | 29.03.2019 | 318 | Paguar sipas fakt.318/III | 0.00 | 1,000.00 | 0.00 |
| 1329 | 21.01.2021 | 400-51408 | Ngarkimi I qeras nga dt.01.01-31.12.2021 | 1,200.00 | 0.00 | 0.00 |
| 1329 | 26.11.2020 | 01-400-51408 | Ngarkimi I qera,nga dt.26.11.-31.12.2020 | 115.15 | 0.00 | 0.00 |
| 1329 | 27.03.2026 | 326000008 | Pagesë e qirasë sipas fakt.nr.326000008 | 0.00 | 1,200.00 | 0.00 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Totali i Debis | 11,315.15 | Totali i Kredis: | 10.200.00 | Totali i salldos | 1.115.15 |

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA GLLOGOC
GLLOGOC MUNICIPALITY

| PRANUAR | | 15\06\ 2026 | |
|---|---|---|---|
| Nj. Org. | Numër | Shtojca | Vlera |
| 07 - | 052\03- | 22640 | |

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
Republika Kosova-Republic of Kosovo
**Komuna Drenas/Gllogoc**
Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë

Bazuar në nenin 22, par.1 të Ligjit nr.06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme te komunës si dhe nenin 27, par 1 dhe 2 të rregullorës (QRK) nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës, Drejtoria për Gjeodezi, Kadaster dhe Pronë - Sektori i Pronës lidhur me mbikëqyrjen e kontratave për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të komunës paraqet këtë:

# R A P O R T

**Zyrtarja për menaxhimin e pronave komunale të dhëna në shfrytezim, në zbatim të detyrave që rrjedhin nga Ligji per dhënien në shfrytëzim dhe këmbim te prones se paluajtshme komunale dhe Rregullores (QRK) NR.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës, pas verifikimit të gjendjes në teren raporton te gjeturat e saj mbi gjendjen faktike lidhur me përmbushjen e kontratës Nr.463-49130, dt.11.11.2014 Kryetarit te Komunes së Drenasit:**

Kontrata mbi dhënien në shfrytezim afatëgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës Nr.463-49130, dt.11.11.2014, është e lidhur në mes te Komuna e Drenasit e përfaqësuar nga ish-Kryetari i Komunës z.Nexhat Demaku në njëren anë dhe N.T.SH "KALAJA E GURIT", me seli në Komoran, me nr te biznesit 810199027, te cilën e përfaqëson z. Hafiz Hajdini në anën tjetër, përmes së cilës N.T.SH "KALAJA E GURIT", merr në shfrytëzim afatëgjatë për 40 (katërdhjetë) vite pronën komunale, parcelen nr.4-90, sipërfaqe 0.15 ha, në vendin e quajtur Fusha e Gjerë, zona kadastrale-Komoran.
Obligimet ndërmjet palëve kontraktuese kanë filluar nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate 11.11.2014 dhe shfrytëzuesi i pronës komunale ka qenë i obliguar të i përmbahet obligimeve të përcaktuara me kontratë.

- Pas verifikimit në Kadastër dhe Gjeodezi konstatohet se e drejta e shfrytëzimit të pronës komunale në emër të shfrytëzuesit (Hafiz Hajdini-N.T.SH "KALAJA E GURIT") është e regjistruar në Kadastër RDPP, në pjesën tekstuale dhe grafike
- Me qëllim të verifikimit të kontratës dhe gjendjes së pronës, kemi dalur ne vendshiqim me dt. 18.05.2026 dhe kemi konstatuar se biznesi është aktiv, shfrytëzuesi i pronës komunale në objektin që e ka ndërtuar në tokën e marrë në shfrytëzim është duke ushtruar veprimtarinë e njejtë siç është përcaktuar në nenin 2 të kontratës "Përpunimi i mermerit dhe granitit si dhe prodhues i radiatoreve të mermerit dhe granitit".

- Bazuar në vendimin për Leje Ndërtimore 351-9833 të dt.18.03.2015 të lëshuar nga Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit-shfytëzuesit afatgjatë të pronës komunale i është lejuar ndërtimi i objektit afarist me dimensione 25.00x11.20m, me etazhitet P+0 në afarizëm dhe P+1 administrat.
- Sipas Çertifikatës së Përdorimit 08.Nr.351-54491 të dates 31.08.2016, të lëshuar nga Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit është konstatuar se biznesi në fjalë i ka përmbushur kriteret e ndërtimit të cilat i janë caktuar.
- Pas verifikimit të kontratës dhe gjendjes së pronës, për ne ka qenë e vështirë të përcaktohet vlera e investimeve, shfrytëzuesi i pronës komunale e ka ndërtuar objektin, ka investuar dhe objekti është i përshtatshëm për veprimtarinë e përcaktuar në kontratë dhe pasqyrohet përmes fotografive të bëra në vendshiqim.
- Bazuar në evidencën e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, gjendjen e kartelës nr.1344, të marrë nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa, në emër të shfrytëzuesit të pronës komunale (Hafiz Hajdini) borgji në emër të shfrytëzuesit të pronës komunale është paguar qiraja, ashtu siç është përcaktuar në nenin 4 të kontratës, shfrytëzuesi i pronës komunale është i rregulltë në pagesat e qirasë.
- Sa i përket numërit të punëtorëve, shfrytëzuesi i pronës komunale ka deklaruar listën me 5 (pesë) punëtor të punësuar në këtë biznes ndërsa sipas kontratës përcaktohet që të jenë 49 të punësuar.
- Bazuar në raportin paraprak të pronave komunale të dhëna në shfrytëzim, Zyra e Kryetarit këtij biznesi me dt.06.05.2026 i ka dërguar vërejtje me shkrim për përmbushjen e obligimit kontraktual të kontratës mbi dhënien në shfrytëzim afatëgjatë të pronës komunale, përkatsisht për përmbushjen e kriterit të punësuarve.

Pas verifikimit të kontratës numër 463-49130 e datës 11.11.2014, gjendjes së pronës në parcelën numër 4-90 zona kadastrale Komoran dhe evidencës së Drejtorisë për Buxhet dhe Financa pas prezantimit të gjëndjes faktike, rekomandojm Kryetarin e Komunës që të ndërmarr veprime sipas kritereve të përcaktuara në kontratë dhe legjislacionit në fuqi dhe të i shqiptojë vërejtje me shkrim për mos përmbushje të kriterit kontraktual të punësuarve.

Zyrtare për Menaxhimin e Pronës Komunale

Dafina Leku

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO - KOMUNA GLLOGOC - OPŠTINA GLOGOVAC - MUNICIPALITY GLLOGOC




KALAJA e GURIT
GRANIT


GRANIT

5

# REPUBLIKA E KOSOVËS
## KOMUNA E DRENASIT
### ZYRA E KRYETARIT

NR. 463-49130 dt. 11.11 2014

# KONTRATË
## MBI DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË PRONËN E PALUAJTSHME TË KOMUNËS.

E LIDHUR MË DATËN 11.11. 2014 NË MES :

1.KOMUNA E DRENASIT të cilën e përfaqëson Kryetari i Komunës z.Nexhat Demaku (në tekstin e mëtejmë: Dhënësi i tokës në shfrytëzim afatgjatë).

dhe

2.NTSH "KALAJA E GURIT" me seli në Komoran,me numer të biznesit 80479344 të cilën e përfaqëson Drejtori Hafiz Hajdini nga fsh.Komoran , Komuna e Drenasit (në tekstin e mëtejmë: shfrytëzuesi afatgjatë i tokës).

BAZA JURIDIKE:

I.

Është nenit 14.2 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale,neni 9 paragrafi 5 i Ligjit nr.04/L-144 për dhënien në shfrytëzimin dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës,neni 18 paragrafi 6 të Rregullores QRK nr.23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës dhe Vendimit me Nr.353-31851 të datës 23.07.2014 të Kuvendit të Komunës,për dhënien e tokave komunale në shfrytëzim afatgjatë.

**OBJEKTI I KONTRATËS:**

**II.**

Është dhënia në shfrytëzim afatgjatë e pronës së paluajtshme të komunës sipas Certifikatës pronësore nr.421-5251 , në zonën kadastrale Komoran,në pjesën e ngastrës nr.4/11-4/90,në sipërfaqe prej 0.15 ha,në vendin e quajtur"Fusha e gjanë" me kulturë kullosë në të cilën do të ndërtohet objekt për ushtrimin **.Perpunimi i Mermerit dhe granitit si dhe prodhues i Radiatorve të Mermerit dhe granitit**

**AFATI KOHORË:**

**III**

Afati kohorë për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës sipas pikës dy(II)të kësaj kontrate është katërdhjetë(40) vite,nga dita e nënshkrimit të kësaj kontrate nga 22.10.2014 gjer më 21.10.2054 me mundësi të vazhdimit apo shkëputjes duke respektuar Ligjin e zbatueshëm të vitit skadues të kësaj kontrate,si dhe me mundësinë e tërheqjes prej gjashtë (6)muajsh nga dita e paraqitjës së kërkesës nga njëra palë kontraktuese.

**ÇMIMI:**

**IV.**

Çmimi për shfrytëzimin afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës sipas pikës dy(II)të kësaj kontrate caktohet në lartësi prej 2.95 €.m² vitë në bazë të çmimit konkurues dhe rekomandimit të komisionit për përzgjedhjen e ofertës ekonomikisht më të favorshme duke filluar nga data 01.04.2015 në fillim të muajit e atë me së largu gjer me datën pesëmdhjetë(15)të muajit vijues,në të kundërtën do të ndërpritet kontrata në mënyrë të njëanshëme pa paralajmërim.

**OBLIGIMET RECIPROKE**

V

